



REPUBLIKA E SHQIPERISE
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1215, datë 07. 04 .2010

per

**“Publikimin e raportit te AKEP mbi keshillimin publik te realizuar per dokumentin
“Pagesat qe kryhen ne AKEP”.**

Këshilli Drejtues (**KD**) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (**AKEP**), i përbërë nga:

- | | | |
|----------------|------------|---------|
| 1. Z. Piro | Xhixho | Kryetar |
| 2. Znj. Alketa | Mukavelati | Anëtare |
| 3. Z. Benon | Paloka | Anëtar |
| 4. Z. Ibsen | Elezi | Anëtar |
| 5. Znj. Zamira | Nurçe | Anëtare |

në mbledhjen e datës 07.04. 2010, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, mori ne shqyrtim relacionin nr. 1354 prot, date 02.04.2010 te Grupit te punes dhe diskutoi materialin e pergatitur “ Per pagesat qe kryhen ne AKEP”.

BAZA LIGJORE:

1. Neni 7, neni 110 te ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “ Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”;
2. Pika 3.10 e “Udhezues per procedurat e keshillimit me publikun” miratuar me VKD nr. 1183, date 10.3.2010.
3. Pika 17 e nenit 21 “Rregullores së Brendëshme të AKEP (ish ERT) miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918;

Nga diskutimi duke iu referuar dhe bazes ligjore te sipercituar :

V Ë R E H E T se :

Materiali i pergatitur per publikimin e raportit te AKEP mbi keshillimin publik te realizuar per dokumentin “Pagesat qe kryhen ne AKEP”

Me qëllim qe:

- Palet me interes te njihen me një pasqyrë të komenteve të pranuar, përgjigjes së AKEP-it si dhe vendimit të tij lidhur me çështjen e nxjerrë për këshillim,

V E N D O S I :

1. Të publikoje raportin e AKEP mbi procesin e keshillimit publik te perfunduar me palet e interesit per dokumentin “Mbi pagesat qe kryhen ne AKEP”.
2. Ky vendim hyn në fuqi daten e miratimit te tij.

KRYETAR I KESHILLIT DREJTUES

Piro XHIXHO

Anëtarët e Këshillit Drejtues :

Alketa MUKAVELATI

Benon PALOKA

Ibsen ELEZI

Zamira NURÇE

PERMBAJTJA

1. HYRJE	2
2. PËRMBLEDHJE	4
3 PALET ME INTERES QE KANE PARAQITUR PERGJIGJE.....	5
4.ÇESHJET E KESHILLIMIT PUBLIK	5
4.1 PËRDORIMI OPTIMAL I SPEKTRITRADIO.....	5
41.1 Përmbledhje e Temave te Keshillimit.....	5
41.2 Mendime te paleve me interes.....	6
4.1.3 Qendrimi i AKEP.....	7
4.2. SHERBIMI TELEFONIK PUBLIK I LEVIZSHEM TOKESOR	8
4.2.1 Përmbledhje e Temave te Keshillimit.....	8
4.2.2 Mendime te paleve me interes.....	9
4.2.3 Qendrimi i AKEP.....	10
4.3 LIDHJET FIKSE RADIO.....	11
4.3.1 Përmbledhje e Temave te Keshillimit.....	11
4.3.2 Mendime te paleve me interes.....	13
4.3.3 Qendrimi i AKEP.....	16
4.4 SHERBIMI RADIO FWA/BWA	20
4.4.1 Përmbledhje e Tema te Keshillimit.....	20
4.4.2 Mendime te paleve me interes.....	20
4.4.3 Qendrimi i AKEP.....	21
4.5.AUTORIZIMET INDIVIDUALE PER QELLIME KERKIMI, MATJEJE	21
4.5.1 Përmbledhje e Tema te Keshillimit.....	20
4.5.2 Mendimi i paleve me interes.....	20
4.5.3 Qendrimi i AKEP.....	22
4.6 PAGESAT PER CAKTIMIN DHE PERDORIMIN E NUMRAVE DHE SERIVE NUMERIKE.....	22-34
4.6.1 Përmbledhje e Temave te Keshillimit.....	22-34

4.6.2 Mendime te paleve me interes.....	22-
34	
4.6.3 Qendrimi iAKEP.....	22-
34	

1. HYRJE

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare-AKEP, me 26 Janar 2010, publikoi per keshillim publik dokumentin “Per pagesat qe kryen ne AKEP”. Qellimi i ketij keshillimi publik ishte qe AKEP per te njihej me pikepamjet e sipermarreve, operatore rrjeti dhe/ose ofrues te sherbimeve te komunikimeve elektronike, mbi propozimet per strukturen e llogaritjes, nivelin e pagesave vjetore per perdorimin e spektrit te radios dhe per perdorimin e numrave dhe serive numerike.

AKEP ne propozimet e dhena pervec sa eshte permendur ne dokumentit e Keshillimit Publik, ka patur synim qe shuma e te ardhurave nga keto pagesa te jene te mjaftueshme per shpenzimet administrative te vete institucionit si percakton dhe ligji Nr 9918 date 6.5.2008.

AKEP ne perfundim te periudhes se keshillimi publik, ka marr pergjigjet nga palet e interesuara dhe shpreh kenaqsine per paraqitjen ne vijim te pergjigjeve dhe komenteve te sipermarreserve lidhur me dokumentin e keshillimit publik “ Per Pagesat qe kryen ne AKEP” , ne periudhen 26 Janar – 5 Mars 2010.

AKEP është i vetëdijshëm për nevojën për të zvogëluar barrën e pagesave per perdorimin e spektrit radio, sepse kjo eshte ne te mire te biznesit dhe perdoruesit.

Propozimet e dokumentit per keshillim publk per pagesat per perdorimin e spektrit radio pervec qellimit te transparences se llogaritjes se pagesave, nga te gjitha palet e interesuara, dhe zbatimit te parimit te neutralitetit te sherbimit radio, per keto pagesa, synojne arritjen e qellimeve qe lidhen me perdorimin optimal dhe efektiv te spektrit radio.

Sqarojme se Neni119 i Ligjit Nr 9918, date 19.5.2008, “ Per komunikimet elektronike ne Republiken e Shqiperise”, percakton gjithe llojet e pagesave qe kryen ne AKEP. Dokumenti i keshillimit publik “Per pagesat qe kryen ne AKEP”, ka trajtuar vetem pagesat per perdorimin e frekuencave, numrave dhe serive numerike, pra vetem pagesat sipas Pikes 1.c dhe 1,ç te atij neni.

Megjithate, AKEP vlereson mendimet, sugjerimet dhe opinionet e sipermarresve, ne pergjigje te ketij keshillim publik edhe per pagesat, qe nuk kane qene objekt i tij, por qe lidhen me te ardhurat e AKEP apo dhe per tarifen e sherbimit te radiokomunikacionit qe jane pagesa, te cilat nuk perfshihen ne planin e shpenzimeve te AKEP.

AKEP, nisur nga fakti se palet me interes kane dhene verejtje dhe mendime per probleme te ndryshme nga pyetjet e dokumentit te keshillimit publik, lidhur me pagesat per perdorim dhe tarifat per sherbimin radio, duke i trajtuar ato si pages ate dyfishta, per mos publikim e planit te shpenzimeve, sqarojme sa vijon:

Buxheti i AKEP perbehet nga pagesat sipas nenit 119 te Ligjit nr.9918, date 19.05.2008 “Per Komunikimet Elektronike ne R.SH”.

Ne kete dokumentin e keshillimit publik kemi pasur si qellim llogaritjen e pagesave per dhenien dhe perdorimin e frekuencave, duke u bazuar ne efektivitetin dhe parimin e mosdiskriminimit, si dhe duke marre per baze nje perafrim me tarifat qe aplikohen ne rajonin tone. Lidhur me kete te fundit theksojme se pagesat per perdorimin e frekuencave, sipas llogaritjeve qe kemi propozuar perseri mbeten ne nivele shume me te uleta krahasuar me vendet e rajonit.

Sa i perket menyres se mbajtjes se llogarive ne kontabilitet, ndarjes dhe publikimit te tyre me qellim qe te jemi sa me transparent me palet me interes, AKEP deshiron tju garantoje se:

1. Buxheti i AKEP i hartuar sipas nevojave te institucionit per shpenzime administrative dhe investime me qellim permbushjen e detyrave per mbikqyrjen dhe rregullimin e tregut te komunikimeve elektronike, do te mbaje parasysh faktin qe pagesat e sipermarresve te perligjin plotesisht kete buxhet duke mos lejuar devijime dhe abuzime. AKEP, si nje institucion i pavarur, planifikon te ardhurat ne te njejtin nivel me shpenzimet qe ka planifikuar per ate vit.

2. Buxheti i AKEP, pasi argumentohet ne te gjitha zerat perberes para Keshillit Drejtues te AKEP, paraqitet ne Ministrine e Financave dhe ne Ministrine e Shtetit per Reforma, dhe miratohet me Vendim te Keshillit te Ministrave. Ky buxhet ne formen e planit te shpenzimeve publikohet ne lidhjen 1 qe i bashkengjitet vendimit, duke percaktuar shumen totale te ndare ne pese zerat kryesor qe jane:

- a. Paga
- b. Sigurime shoqerore dhe shendetesore
- c. Materiale
- d. Sherbime dhe,
- e. Investime

E pare ne kete aspekt te gjitha sipermarresit mund te marrin informacion lidhur me shumen totale qe ka planifikuar AKEP per mbulimin e shpenzimeve administrative.

Megjithese Ligji i ri per komunikimet elektronike ka hyre ne fuqi qe ne vitin 2008, AKEP per llogaritjen e pagesave per frekuenca dhe numeracion ka perdorur VKM nr.75, date 06.02.2003 “Per miratimin e pagesave qe kryhen ne ERT”. AKEP ka mbajtur dhe mban llogari te ndara per te ardhurat, jo vetem sipas natyres se tyre (frekuenca, numeracion etj), por edhe sipas kategorive te sipermarresve (Opreatore publike GSM, Operator te klasit II, ISP, OSHT, Satelitore etj). Edhe per vitin 2010 po vijohet me llogaritjet e pageses sipas VKM nr.75 te lartpermendur.

Me implementimin e akteve te reja nenligjore qe do te dalin ne zbatim te Ligjit nr.9918, date 19.05.2008 “Per Komunikimet Elektronike ne R.SH”, per llogaritjen e pagesave per frekuenca dhe per mbikqyrjen e tregut te komunikimeve elektronike, AKEP do te jete transparent ndaj te gjithe sipermarresve lidhur me pagesat qe ata do te kryejne, duke mbajtur edhe llogari te vecanta ne kontabilitet per te ardhurat qe do te arketohen nga perdorimi i frekuencave, te ardhurat qe do te arketohen nga pagesat per mbikqyrjen e tregut, te ardhurat qe do te arketohen nga Numeracioni, e te tjera.

Sipas perlllogaritjeve qe kemi bere paraprakisht, pjesen me te madhe te buxhetit te AKEP do ta perbejne arketimet nga pagesat qe do te kryejne sipermarresit per frekuenca. Pjesa tjeter do te arketohet nga pagesat per mbikqyrjen e tregut te komunikimeve elektronike. Llogaritjet per keto pagesa do te behen duke zbatuar nenin 24 te Ligjit nr.9918, date 19.05.2008 “Per Komunikimet Elektronike ne R.SH, dhe Rregulloren “Mbi pagesat per mbikqyrjen e tregut te komunikimeve elektronike” miratuar me Vendim te Keshillit Drejtues te AKEP nr.1170, date 19.02.2010.

Si baze per llogaritjen e ketyre pagesave do te jene te ardhurat e sipermarresit te paraqitura ne pasqyrat financiare te nje viti me pare (P.Sh. per pagesat e vitit 2010 do te merret per baze bilanci i vitit 2009).

2 PËRMBLEDHJE

Ky dokument përmban pergjigjet, bashke me komentet edhe verejtjet perkatese, te paraqitura nga palet me interes pas perfundimit te periudhes se keshillimit publik te dokumentit “Per pagesat qe kryen ne AKEP” (per perdorimin e frekuencave, numrave dhe serive numerike). Jane paraqitur gjithesej 32 pergjigje, prej te cilave per:

- a). Perdorimin Optimal te Spektrit Radio 3 pergjigje,

- a) Sherbimi telefonik publik i levizshem tokesor (GSM/UMTS), 3 pergjigje;
- b) Lidhjet fikse radio, 21 pergjigje;
- c) Sherbimi radio FWA/BWA, 2 pergjigje ;
- d) Autorizimet individuale per qellime kerkimi, matjeje dhe prove, 1 pergjigje;
- e) Pagesat per Caktimin dhe Perdorimin e numrave dhe serive numerike, 2 pergjigje.

AKEP, duke pasur parasysh të gjitha përgjigjet, do realizojë reflektimin e shqetësimeve të ngritura, në materialin perfundimtar, për pagesat për përdorimin e frekuencave, numrave dhe serive numerike.

Ky material përfshin përgjigjet e dhëna nga palet me interes për pyetjet dhe propozimet e dokumentit të keshillimit publik “Për pagesat që kryen në AKEP” dhe është një përmbledhje e çështjeve, referuar dokumentit, që u publikua për keshillimit publik, vetëm për pyetjet, për të cilat janë dërguar përgjigje, komente e propozime, nga palet me interes.

Gjithashtu në këto dokument përfshihen dhe mendimet e AKEP për përgjigjet përkatëse të dhëna nga palet me interes.

3 PALET ME INTERES QE KANE PARAQITUR PERGJIGJE.

Përgjigje, vërejtje dhe komente, për dokumentin e keshillimit publik, kanë paraqitur këta sipërmarres:

1. ABCom sh.a
2. Vodafone Albania sh.a
3. Eagle Mobile sh.a
4. Altelecom sh.a
5. Albanian Mobile Communications sh.a.

4. ÇESHTEJET E KESHILLIMIT PUBLIK.

4.1 PËRDORIMI OPTIMAL I SPEKTRIT RADIO

4.1.1 Përmbledhje e dokumentit të keshillimit publik

Dokumenti i keshillimit publik përshkruan faktorët kryesorë, që janë marrë parasysh nga AKEP, për kryerjen e detyrës ligjore, sigurimin e përdorimit optimal të spektrit radio, të cilët janë:

- a) Vlera ekonomike e përdorimit të spektrit nga përdoruesit individual; p.sh. sherbimi telefonik i levizshem,
- b) Vlera social-ekonomik përfitimet e përdorimit të spektrit radio, p.sh përdorimin e radio për sherbime emrgjence, ndihme dhe sigurie, shërbimet për bizneset e vogla;
- c) Përfitimet sociale, p.sh. promovimin e teknologjive të reja;

- c) Plotesimi i objektivave te politikës p.sh mbështetjen e transmetimeve me brez te gjere dhe/ose nxitjen konkurrencës;
- d) Respektimi i standardeve dhe rekomandimeve te institucioneve nderkombetare, eliminimin e interferencave;
- e) Faktorët teknologjik, si pajtueshmeria e karakteristikave fizike dhe teknike te pajtuesve radio per pjese te ndryshme te spektrit;
- f) Koston mundësi, ku një lloji sherbimi me përdorimit të caktuar spektrit mohon qasje në te' te një sherbimi tjetër, që mund të ofrojnë përfitime më të mëdha ekonomik ose te tjere.

Pyetja 1.

A ka faktorë të tjerë, te pa përmendur më sipër, që AKEP duhet të marrë në konsideratë per përdorimin optimal të spektrit të radios dhe vendosjen e pagesave per përdorimin e spektrit te frekuencave?

4.1.2 Qendrimet e paleve me interes.

Jane dhene 3 përgjigje për këtë pyetje.

Nje i interesuar, operator rrjeti dhe ofruer sherbimesh publike shprehet se AKEP ka permendur dhe ka marre ne konsiderate te gjithë faktoret per përdorimin optimal te spektrit dhe vendosjen e pagesave per përdorimin e spektrit te frekuencave radio.

I interesuari i dyte sugjeron se faktore, qe duhen te merren parasysh, per përdorimin optimal te spektri radio jane:

- Stimulimi i investimeve me brez te gjere.
- Krijimi i nje kuadri rregullator te qarte dhe te drejte mbi trajtimin fiskal te përdorimit te frekuencave radio (arsyeja e ekzistences se pageses rregullatore)

Dhe se eshte e nevojshme:

Rishikikimi i barres tarifore, pasi ka mbivendosje dhe tarifim të dyfishtë.

- Përcaktimin e kufirit të qartë, logjik dhe ekonomikisht racional mes a.) taksës që shkon në buxhetin e shteti për përdorim të brezit të frekuencave, ku AKEP luan rolin e agjentit tatimor, dhe b). pagesës ndaj AKEP për menaxhimin e spektrit, pagesë që duhet përlogaritur në përputhje me kostot reale administrative të AKEP. Kjo do të kërkonte:

- Rishikimin e Udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Financave dhe AKEP Nr. 28 datë 06.10.2008 “Për përcaktimin e e tarifës së shërbimit për shërbimet e radiokomunikacionit” mbi përlogaritjen e pagesave.
- Rishikimin e klauzave përkatëse të Vendimit nr, 1128, datë 26.01.2010 ‘Për Miratimin e Dokumentit për Këshillim Publik “Mbi pagesat që kryhen në AKEP”, që synon të shfuqizojë VKM nr 75 përsa i përket pagesave.
- Rishikimin e Ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare” përsa i përket tarifave përkatëse për shërbimin e radiokomunikacioneve dhe konceptimin e tyre.

Kurse i interesuari i fundit, qe ka derguar pergjigje per kete pyetje, sugjeron se faktore, qe duhet te meren parasysh jane:

- Garantimi i plotesimi te kerkesave e te gjitha sherbimeve radio dhe qe ka balance me politikat publike;
- Maksimizimi i perfitimeve sociale nga perdorimi i radiofrekuencave .sh. ne lidhje me sigurine kombetare, shendetin publik,etj.,
- Rritjen e konkurrences duke siguruar qe eshte alokuar dhe caktuar te perdoret spektri adekuat qe con ne vleren me te larte ekonomike te perfituar prej tij.
- Garantimi qe perdorimi i spektrit behet ne konformitet me detyrimet kombetare dhe nderkombetare dhe inspektive per tu siguruar per mosegzistencen e perdorimeve pirate te radiofrekuencave (monitorimi).
- Fleksibiliteti ne analizen e perdorimit te spektrit me qellim adaptimin me ndryshimet e vazhdueshme ne teknologji, ne kerkesa, treg dhe ne politika publike.

4.1.3 Qendrimi AKEP

AKEP, eshte perpjekur te respektoje e zbatoje te gjitha detyrimet ligjore dhe nenligjore lidhur me plotesimin e kerkesave te paleve me interes, sipermarres privat apo publik dhe te institucioneve shteterore, per perdorimin e spektrit te radios, duke patur parasysh rekomandimet e institucioneve nderkombetare, praktikate e vendeve te tjere dhe përcaktimin e kushteve dhe kerkesave per perdorim e ketij spektri.

Megjithse në situatën aktuale, verëhet një zhvillim i shpejtë i tregut të komunikimeve elektronike, është e rëndësishme të pohohet se ka hapsira reale për futjen në këtë treg të shërbimeve të reja radio si dhe të teknologjive që dalin të reja.

Miratimi i Planit Kombëtar të Frekuencave Radio (VKM Nr Nr479 dt. 6 Maj 2009), hartimi i Planit të Perdorimit të Freuencave (një pjesë e të cilit është publikuar në faqen elektronike të institucionit), miratimi i rregullores “Për kushtet e perdorimit të frekuencave dhe kerkesat teknike per pajisjet radio qe perdoren pa

autorizim individual” (VKD Nr.1126,date 08.01.2010) dhe pergatitja e kushteve teknike per perdorimin e spektrit per sherbimet e ndryshme radio, qe do te realizohet gjate ketij viti, mendojme se jane disa faktore qe do te ndikojne ne nje administrim me efektiv te spektrit dhe ne plotesimin e kerkesave te palet me interes, sipermarres aktual dhe atyre te rinje, per sherbimet dhe teknologjite e reja radio .

AKEP njeh plotësisht përfitimet që rrjedhin nga standardeve ndërkombëtare të harmonizuara, prandaj ka filluar procedurat e keshillimit publik sherbimit UMTS dhe BWA dhe do te vazhdoje te zbatoje PKRF qe eshte ne perputhje me tabelen e harmonizuar europiane te perdorimit te spektrit.

AKEP vlereson planet aktuale europiane per nje perdorim me fleksibel te spektrit te radios, qe synon bashkekzistencën e shërbimeve te ndryshme radio, duke percaktuar kushtet teknike specifiket per cdo sherbim dhe pajisjet perkatese, per te mundesuar eliminimin e interferencave te demshme midis tyre.

Përgjithësisht, AKEP mendon se përdorimi optimal i spektrit radio bazohet në shumë faktore, disa prej të cilëve janë dhe në përgjigjet e dhena nga palet me interes, të cilët bashkë me faktorët e identifikuar në dokumentin e keshillimit publik, janë bazë për vendimmarrje të drejta për përdorimin e spektrit radio.

4.2 SHERBIMI TELEFONIK PUBLIK I LEVIZSHEM TOKESOR

4.2.1 Përmbledhje e Keshillimit Publik.

AKEP, në dokumentin e keshillimit publik propozon që pagesat vjetore për përdorimin e frekuencave të brezave 900, 1800 MHz dhe (1900-1920) MHz dhe (2020-2025) MHz të jenë si vijon:

- Per brezin GSM900, cdo kanal 2x200 kHz : 120.000 leke
- Per brezin GSM1800 cdo kanal 2x200 kHz: 100.000 leke
- Per brezat UMTS:
 - i. Ne brezin (1920-1980) dhe (2110-2170) MHz,
per cdo brez frekuece me gjeresi (2x5) MHz: 2.000.000 leke
 - ii. Ne brezin (1900-1920) MHz dhe (2010-2025) MHz, per cdo gjeresi brezi
(1x5) MHz, perdorim jo i ciftuar me brez tjeter: 1.000.000 leke

Pyetja 2.

Cilat janë pikëpamjet tuaja për pagesat vjetore që propozohen për brezat GSM900/1800 dhe UMTS?

4.2.2 Mendime të paleve me interes.

Jane dhene 3 përgjigje për këtë pyetje.

Nje i interesuar propozon mos ndryshimin e pagesat aktuale vjetore per brezat GSM900/1800 MHz.

I interesuari i dyte,

a) Shpreh rezerva dhe nuk kupton aryen pse pagesa per kanalet e frekuencave te GSM 900 MHz jane propozuar te rriten kur, ky brez frekuencash eshte pothuajse i dhene terresisht per perdorim, prandaj sugjeron qe,

b) Vemendja te perqendrohet tek GSM1800, eliminimi i interferencave, qe verehet gjate operimit ne keto breza frekuencash, dhe se,

c) Kerkon sqarim se sa do te jene pagesat per brezat 900 dhe 1800 MHz per perdorimin e tyre sipas standardit UMTS.

d) Kerkon te dije a ka parashikuar AKEP, hapa konkrete per perdorimin e brezave qe do te mbeten te lire nga procesi "digital dividend", per sherbimet e tjera radio dhe sa do te jete pagesa per perdorimin e ketij spektri.

Gjithashtu, i interesuari i trete e konsideron te:

a) Paarsyeshme rritjen e pageses vjetore per brezat; prandaj propozon qe,

b) Keto pagesa te mbeten ne nivelin aktual;

por dhe e kundërshton parimisht kete pagese vjetore me arsyetimin se keto pagesa

c) Jane shlyer me vleren e tregut te frekuencave ne perdorim ne momentin e marrjes se te drejtes

se shfrytezimit (dmth, licensimi); dhe se per sherbimin UMTS (3G),

d) Ne caktimin e pagesave duhet te merret ne konsiderate ecuria e ketij sherbimi (UMTS) ne

vendet e BE, qe investimet e kryera nuk kane sjell fitimet e pritura.

e) Te rishikohen gjithe pagesat per perdorimin e frekuencave sepse perdoruesit tarifohen dyfish,

(pagese per Perdorim dhe pagese Tarife).

f) Pagesa per UMTS eshte e njete me ate te brezit 2G.

4.2.3 Qendrimi i AKEP

AKEP, si dhe deri tani, aktualisht por dhe ne te ardhmen, nuk ka manifestuar imponim per asnje problem, dhe aq me pak per pagesa rregullatore. Eshte perpjekur te respektoje e zbatoje te gjitha detyrimet ligjore dhe nenligjore lidhur me plotesimin e kerkesave te palet me interes, sipërmarres publik dhe institucioneve shtetere, per perdorimin e spektrit te radios, duke patur parasysh rekomandimet e institucioneve nderkombetare, praktikat e vendeve te tjere dhe percaktimin e kushteve dhe kerkesave per perdorim e spektrit te radios.

Ne propozimet e pagesave per brezat GSM 900/1800 MHz dhe UMTS, AKEP eshte nisur nga karakteristike teknike te perhajes se valeve te brezave te ndryshem.

Mendimi i dhene nga nje i interesuar se gjithë brezi GSM 900MHz, eshte dhene per perdorim, prandaj AKEP te merret me brezin GSM1800, ne te cilin ka interferenca, nuk e konsiderojme te drejte. Eshte detyre ligjore e AKEP qe, per te gjithë brezat e frekuencave, te garantoje funksionimin normal dhe pa interferenca gjate perdorimit te tyre dhe te propozoje pagesen per cdo njerin prej tyre duke marre parasysh gjithë faktoret perkates teknike dhe ekonomik.

Tashme jane te njohura rezultatet teknike te institucioneve nderkombetare qe kane cuan ne perfundimin se rrjetet UMTS 900/1800 do të funksionojne paralelisht me rrjetet GSM 900 / 1800 MHz, qe shtrihen pervec zona urbane dhe ne ato gjysëm-urbane dhe rurale.

AKEP, ne zbatim te politikave te zhvillimit te sektorit te komunikimeve elektronike, bazuar ne Ligjin per Komunikimet Elektronike dhe Postare, ne PKRF, vendimet dhe rekomandimet te institucioneve europiane, do te paraqes kushtet teknike te perdorimit te brezave 900/1800 MHz, ne menyre qe te dy sherbimet te mos kene interferenca reciproke.

AKEP lidhur me brezat qe mbeten te lire nga procesi “digital dividet”, ne baze te vendimeve dhe rekomandimeve te institucioneve europiane, qe kane planizuar miratimin e tyre ne fillim te ketij viti, do te percaktoje hapat e duhur qe brezi i lire 800 MHz, te jepet per perdorim per sherbimet radio me brez te gjere, ne baze te procedurave qe percakton ligji. Pagesat per perdorimin e ketij brezi do te percaktohen ne te ardhmen.

Pagesat e propozuara per brezin 900/1800 MHz, duke respektuar parimin e neutralitetit teknologjik dhe te sherbimit, do te aplikohen si per sherbimin GSM dhe ate UMTS. Pra, palet me interes do te kryejne pagesen vjetore te brezit 900 MHz dhe 1800MHz, aq sa eshte prozozuar ne dokumentin e keshillimit publik, pavaerisht se cfare sherbimi ofron: GSM 900/1800 apo UMTS 900/1800.

Llogarite e kryera nga nje i intereuar dhe konkluzioni qe ka arritur se pagesat e propozuara per sherbimin 3G (mendojme se i referohet pagesave te brezit (1920-1980) dhe (2110-2170) MHz), jane te njejta me ato te 2G, nuk jane te sakta dhe i gabuar.

Pagesat e propozuara per brezat (1920-1980) cift me (2110-2170) MHz dhe (1900-1920) MHz dhe (2010-2025) MHz jane 20 % me te ulta se pagesat vjetore aktuale qe aplikohen per brezat GSM 900/1800.

Referuar argumentave te me siperme, per perdorimin e brezit 900 MHz per GSM 900 dhe UMTS1800 MHz, cilesite e avantazhet e atij brezi, eshte propozuar pagesa vjetore 120 mije leke per cdo kanal 2x200kHz.

Perfundimisht,

AKEP, duke marre ne konsiderate verejtjet dhe sugjerimet e paleve te interesit, mendon qe:

- a) Pagesat vjetore per cdo kanal 2x200 kHz ne brezat 900/1800MHz, pavaresisht sherbimit per te cilin perdoret: GSM apo UMTS, te jete 100.000 leke.
- b) Pagesat vjetore ne:
 - Brezin (1920-1980) dhe (2110-2170) MHz, per cdo brez frekuece me gjeresi (2x5) MHz: 2.000.000 leke
 - Brezin (1900-1920) MHz dhe (2010-2025) MHz, per cdo gjeresi brezi (1x5) MHz, perdorim jo i ciftuar me brez tjeter: 1.000.000 leke

4.3 LIDHJET FIKSE RADIO

4.3.1 Përmbledhje e Temave te Keshillimit

Dokumenti i keshillimit publik evidenton objektivin kryesor te AKEP, ne perdorim e spektrit radio,

- a) Lehtesimin e hyrjes se operatoreve te rinje ne tregun e komunikimeve elektronike,
- b) Nxitjen e perdorimit te pajisjeve radio qe kane efikasitet te larte te perdorimit te spektrit. Kjo, vecanerisht, eshte e rendesishme ne drejtimet dhe vendet e instalimit ku ka nje perqendrim te larte te pajisjeve te lidhjeve fikse radio, sidomos te atyre qe perdorin brezat e frekuencave, te caktuar per perdorim me kapacitet te larte transmetimi dhe per distance te gjata lidhjeje.

Dhe propozohet nje strukture e re llogaritje te pageses vjetore me formulen:

Pagesa vjetore e nje lidhje fikse radio [leke] = Pagesa baze x kF x kB,

ku:

- a) Pagesa baze eshte: **10,000.00** leke.
- b) kF : eshte Koeficienti i Brezit te Frekuences
- c) kB : eshte Koeficienti per gjeresi kanalit.

Detaje te pagesave vjetore per breza te ndryshme te frekuencave dhe te gjerise se kanalit te frekuencave radio jane dhene ne Talela 2.

Gjithashtu ne ate dokument u paraqiten dhe propozimet e meposhteme per pagesat:

- a) Lidhja fikse radio qe perdor te dy polarizimet H dhe V per nje kanal te vetem frekuencash radio do te kete pagese vjetore si nje lidhje e vetme me nje polarizim.
- b) Lidhja radio PMP do te kete pagese vjetore 4 here me te madhe se ajo e lidhjes radio PP.
- c) Pagesa per caktim e frekuencave te lidhjes fikse radio per cdo aplikim te ri, modifikim dhe rinovim te Autorizimit Individual per perdorimin e frekuences eshte **1.000** leke.
- d) Lidhja radio nje drejtimshme do te kete pagesen vjetore sa gjysma e lidhjes fikse radio dydrejtimshme.
- e) Pagesa e lidhjes radio, do te llogaritet proporcional me kohen, por pagesa minimale do jete ajo per perdorim 1 muaj.
- f) Llogaritja e pagesave, per lidhjen fikse radio te modifikuar apo te ndryshuar, per perdorim deri ne perfundim te vitit kalendarit, do te behet proporcionalisht me afatin e vlefshmerise se perdorimit, per muaj, bazuar ne pagesen vjetore. Vlera e pageses vjetore te ketyre lidhjeve fikse radio, te modifikuar apo te ndryshuar, do te krahasohet me ate qe eshte kryer ne fillim te vitit, per lidhjet ekzistuese. Kur vlera e pageses se lidhjes radio te modifikuar apo te ndryshuar, eshte me madhe se ajo e fillimit te vitit, subjekti duhet te paguaje diferencen. Kur vlera e pageses se lidhjeve radio te modifikuar apo te ndryshuar, eshte me vogel se ajo e fillimit te vitit, subjekti nuk do te ribursohet per diferencen.

PYETJET:

Pyetja 7. Cilat janë pikëpamjet tuaja për objektivat e deklaruar te AKEP lidhur me spektrin, për të lehtësuar hyrjen në treg dhe për të përdorur alternativa te tjera te infrastruktures; për të inkurajuar përdorimin e fibrave nga operatorët ekzistues, kerkesat e te cileve per kapacitete transmetimi janë rritur në atë masë, duke bere që fibra optike te jete një alternativë e mundshme, dhe për të inkurajuar përdorimin e pajisjeve me efikase te perdorimit te spektrit?

Pyetja 8. Cilat janë pikëpamjet tuaja mbi pagesat e përdorimit te spektrit për të arritur këto objektiva?

Pyetja 9. A ka objektiva të tjera apo konsiderata që ju mendojnë se AKEP duhet të marrë parasysh kur të përcaktoje pagesat per lidhjet fikse radio?

Pyetja 10. Cilat janë pikëpamjet tuaja mbi procesin e pajisjes me AI per perdorimin e frekuencave per lidhjet fikse dhe per pagesat e propozuara?

Pyetja 11. Cfare mendimi keni per propozim, për të aplikuar një tarifë të vetme ku të dyja polarizimet H dhe V janë vendosur në të njëjtën lidhje radio dhe të njëjtën frekuencë?

Pyetja 12. A pajtoheni me propozimin për të aplikuar një pagese per lidhjen PMP, 4 here me te madhe se pagesa e lidhjes P-P? Nëse nuk pajtoheni, cila eshte alternativa qe ju propozoni?

Pyetja 13. A pajtoheni me propozimin për të aplikuar një pagese per lidhjen fikse radio nje drejtimshe 2 here me te vogel se pagesa e lidhjes fikse perkatese dydrejtimshe? Nëse nuk pajtoheni, cila eshte alternative qe ju propozoni?

Pyetja 14. A keni ndonje mendim tjetër që duhet te merret ne konsiderate nga AKEP?

4.3.2 Mendime te paleve me interes.

Per keto pyetje (nga Nr.7 deri Nr.14) jane dhene gjithsej 21 pergjigje.

Pyetja 7: Jane dhene 2 pergjigje.

Nje i interesuar shprehet dakort me objektivat, por ka verezjtje se nuk jepen opsione per te arritur keto objektiva dhe se, ne kushtet e terrenin e vendit tone, transmetimi me radio eshte alternative e vetme per te ofruar sherbimet ne zonat e largeta rurale, prandaj duhet te hartohet nje politike pagesash e kujdesshme.

I interesuari tjetër shprehet se eshte dakort per nxitjen e perdorimit me efektivitet te spektrit radio, por transmetimi radio mbetet paresor perderisa nuk ka nje rrjet kabllor kombetar me FO, dhe se kjo nuk duhet te shpjere ne imponimin e tarifave te larta per lidhjet radio.

Pyetja 8: Jane dhene 3 pergjigje.

Dy te interesuar shprehen dakort me metoden e re te llogaritjes se pagesave vjetore, qe merr parasysh kohen e perdorimit te lidhjet fikse; dy te interesuar konsiderojne se pagesat per lidhjet fikse jane te rritura krahasuar me ato aktuale; kurse nje i interesuar tjetër shpreh rezerva ne percaktimin e koeficenteve per llogaritjen e pagesave vjetore.

Pyetja 9: Jane dhene 2 pergjigje

Nje i interesuar shpreh mendimin se ne llogaritjen e pagesave per lidhjet fikse duhet te merret ne konsiderate zona ku do te shtrihet rrjeti i transmetimit me qellim rritjen e fisibilitetit ekonomik ne zonat e veshtira.

I interesuari tjetër shprehet se pagesat per lidhjet fikse radio duhet te jene te justifikuara e proporcionale dhe duhet qe AKEP te kete argumenta se keto pagesa jane te nevojshme per te mbuluar kostot shtese administrative. Gjithashtu shprehet se pagesat per lidhje fikse radio duhet te jene proporcionalisht me vleren e spektrit dhe propozon:

a) Ndarjen e brezit 1-17 GHz dhene ne tablen Tab2, ne dy pjese:

(1-10) GHz dhe (10-17) GHz.

b) Ndarjen per gjeresine e kanalit radio, po ne tablen Tab.2 me gjeresi minimale deri/ baras 7 MHz, ne vend te atij deri 3.5 MHz.,

Dhe se,

c) Vlera e 1 MHz , ne brezin e frekuencave 1-10 GHz, nuk eshte i njete per gjeresi te ndryshme kanali radio 3,5 dhe 14 MHz

Pyetja 10: Jane dhene 3 pergjigje.

Nje i interesuar konsideron se:

a).Kwadri ligjor per pajisjen me Autorizim individual eshte i pershtatshem dhe efikas, por kwadrin rregullator qe zbatohet nga AKEP e konsideron te manget, jo transparent dhe ka mungese pergjegjesie per zbatimin e kwadrit ligjor.

b).Pagesat e propozuara per lidhjet fikse jane barre e rende financiare per operatoret.

c).Shprehet se stimulimi dhe perdorimi i infrastrukturave te tjera ndikon ne optimizimin e perdorimit te brezave te frekuencave per lidhje fikse, por AKEP nuk ka miratuar asnje dokument/akt rregullator qe t'i jap shtyqe perdorimit te infrastrukturave alternative transmetimi, perfshi dhe FO.

I interesuari tjetër për këte pyetje deklaroi se ka të njetat konsiderata si dhe përgjigjet e mesipërme e dhëna për pyetjet 7,8 e 9.

I interesuari i tretë, referuar praktikës së vitit 2009, thekson se ka patur vonësia në procesin e pajisjes me autorizim individual për përdorimin e frekuencave dhe se kjo situatë lidhet me:

- a) Mospublikimin e Planit të Përdorimit të Frekuencave,
- b) Mosrespektimi i afatit ligjor për miratimin e kërkesës për Autorizim Individual,
- c) Mungesa e dispozitave që përcaktojnë kur një lidhje fikse konsiderohet e re dhe kur e modifikuar (keto sqarime na janë dhënë në vetëm në mënyrë verbale).
- d) Mungesa e dispozitave që përcaktojnë kohën dhe afatet brenda të cilave duhet të kryhen pagesat për një Autorizimin Individual

Pyetja 11: Jane dhene 3 pergjigje.

Te treja përgjigjet vlerësojnë propozimin për të aplikuar një pagesë të vetme kur të dyja polarizimet H dhe V janë të përdorur në të njëjtën lidhje radio dhe përdorin të njëjtën kanal të frekuencave radio.

Pyetja 12: Jane dhene 3 pergjigje

Një i interesuar rrjeti, konsideron se propozimi për pagesën vjetore të lidhjeve PMP është parimisht i pranueshëm, por mendon se për rritjen e efektivitetit të përdorimit të lidhjeve PMP, pagesat duhet të jenë të arsyeshme dhe se nga AKEP nuk i janë plotësuar kërkesat për lidhjet fikse radio PMP.

Për njerin nga palet me interes nuk është e qartë metodika e përdorur dhe nuk ka argumente të mjaftueshme teknike për aplikimin e pagesës së propozuar dhe, për rrjedhojë, dhe ka mendimin për një pagesë për të vogël, pa dhënë vlerë konkrete.

I interesuari tjetër kërkon sqarim se për çfarë lloj lidhje radio PMP është pagesa sipas pikës 4 të Propozimit në paragrafin 4.5 Lidhjet fikse radio të Dokumentit të keshillimit publik.

Pyetja 13: Jane dhene 2 pergjigje

Dy te interesuar e konsiderojne te drejte propozimin per pagesen vjetore te lidhjes fikse radio njedrejtimshe dhene ne piken 4 te Propozimi ne paragrafin 4.5 Lidhjet fikse radio te Dokumentit te keshillimit publik.

Pyetja 14: Jane dhene 2 pergjigje.

I interesuari propozon qe per pagesat vjetore per lidhjet fikse radio te mos marret ne konsiderate asnje parameter (brez frekuencash, gjeresi kanali), por vetem numri i lidhjeve fikse sipas shkallezimeve : deri ne 100 lidhje , deri ne 200 lidhje .etj., kurse i interesuari i dyte, per kete pyetje thekson tu referohemi pergjigjeve te me parshme.

4.2.2.3 Qendrimi AKEP

Pyetja 7.

AKEP i ka te evidentuar drejtimet, vendet ku alternativa e perdorimit të transmetimit radio eshte e vetme, dhe kjo ka cuar ne rritjen e kerkesave per lidhje fikse radio. Mungesa e alternativave te tjera per transmetim, rritja e lidhjeve te shumfishta radio ne magjistralet kryesore te transmetimit, ka kufizuar hyrjen ne treg ofruesve te rinje dhe ka mundesine te shkaktoje efektit e kundert te konkureses.

Propozimet e pagesave per lidhjet fikse ka patur objektiv inkurajimin e perdorimit te pajisjeve me parametra teknike te tille qe per gjeresi brezi te vogel kapaciteti transmetimit te jete sa me i larte. Gjithashtu proozimi i pageses te lidhjes radio, si nje lidhje e vetme radio, kur perdoren te dy polarizimet, ka patur per qellim zvogelimin e lidhjeve te shumfishta ne drejtime te caktuar.

Ne dokumentin e keshillimit publik, Pika 4.5.Lidhjet Fikse radio, n/pika 8 , paragrafi i fundit, eshte theksuar se AKEP , po punon per hartimin e udhezimeve, kerkesave dhe kushteve teknike, bazuar ne rekomandimet e institucioneve nderkombetare, per perdorimin e spektrit te frekuencave per lidhjet fikse radio dhe se do të shqyrtojë përdorimin e spektrit të caktuar për lidhjet fikse, per te krijuar nje tabllo reale mbi efektivitetit e ketyre lidhjeve radio qe mund të çojë në ndryshime te pagesave per perdorimin e frekuencave.

AKEP beson se një qëndrim nxitës, per perdorimin e pajisjeve qe sigurojne efektivitetin optimal të spektrit, duke aplikuar pagesa te ulta, do te zgjidhet me akte rregullatore per kufizime te detyrueshme per perdorimin e pajisjeve jo efikase.

Pyetjet 8 dhe 9.

AKEP ka shqyrtuar me kujdes gjithë verejtjet dhe sugjerimet e paraqitura nga palet me intereset per menyren e llogaritjes dhe nivelin e pagesave per lidhjet fikse, por mendon se formula e llogaritjes se pageses, ne vartesi te koeficienteve kF dhe kB , siguron ekuilibrin e kenaqshem, midis brezit te frekuencave dhe gjeresis se kanalit radio, per përdorimin efikas të spektrit. Sipas kesaj formule, ne zonat/drejtimet ku kerkesat per lidhje radio jane te shumta dhe realizohen me frekuencave te brezave te ulet te frekuencave, pagesat e propozura jane me te medha se aktualet, por nderkohe pagesat per lidhjet radio, ne brezat e frekuencave te larta, ne drejtimet/zonat e tjera jane me te ulta se ato te tanishme. Ne kete menyre bilanci i

pergjithshem i pagesave vjetore, per perdorimin e frekuencave per lidhjet fikse radio, per palet me interesetit, pergjithsisht ka ndryshime minimale.

Tregu i komunikimeve elektronike vazhdon të rritet me lojtarët e ri, me synim plotesimin e kerkesave te perdoruesit per shërbime më të mira dhe me ekonomike. AKEP synon qe keta sipermarres te rinje, te mund të gëzojnë akses në po ate spekter radio që eshte në dispozicion dhe te sipermarresve ekzistues. Ne vendet ku spektri është i kufizuar ose kërkesa është e lartë, diktohet inkurajimi i përdorimit te alternative të tilla si fibër optike , ne vendet qe kjo eshte e mundur praktikisht, veçanërisht në zonat urbane dhe përgjatë rrugëve kryesore ku kërkesa në rritje për shërbimet me brez te gjere eshte e larte.

Koeficientet kF dhe kB , me vlerat e propozura, per llogaritjen e pageses se cdo lidhje radio kane qellim,

kF – te reflektoje kufizimin e perdorimit me kapacitete te vogel transmetimi te kanaleve te brezave te frekuencave te ulta, per shkak te karakteristikave te tyre, qe realizojne lidhjet radio ne distanca te gjata dhe me kapacitet te larte transmetimi.

kB –te inkurajoje përdorimin e pajisjeve radio me perdorim te efektshem te gjerese se kanalit radio, gjeresi kanali i vogel kapacitet te larte transmetimi.

AKEP, lidhur me pretendimin e nje te interesuari se vlera e spektrit me gjeresi brezi 1 MHz ne brezin 1-10 GHz, Referuar Tabeles 2 te propozimve te pagesave per lidhjet fikse, pranon se eshte i sakte, por kjo nuk mund te pranohet propozimi qe te ndryshoje pragu minimal nga 3.5 MHz ne ate 7 MHz, me arsyetimin se ky brez frekuencash do te perdoret per akses me brez te gjere.

Se pari aksesi me brez te gjere nuk relizohet me frekuenca te brezit 6-10 GHz , PKRF dhe rekomandimet nderkombetare percaktojne breza te tjere frekuencash per ofrimin e atyre sherbimeve (brez te gere). I interesuari, per tu sqaruar lidhur me brezat e frekeuncave qe perdoren per sherbimet me brez te gjere, mund t'i referohet PKRF si dhe materaleve te keshillimit publik

Se dyti standardet e rekomandimet e oganizatave nderkombetare dhe praktikat e vendeve te tjera percaktojne ky brez frekuencash duhet te perdoren per gjatesi te medhe lidhjeje radio (mbi 25 km) dhe shpejtesi te larta transmetimi (mbi 140 Mbit/s). Perdorimi i kanaleve te frekuencave te ketyre brezave ne distanca te vogla dhe gjeresi kanali 3.5 MHz apo 7 MHz, nuk eshte perdorim efektiv i spektrit, prandaj dhe pagesa per 1 (nje) MHz, kur eshte e argumentuar per tu perdorur, per keto gjeresi kanali, duhet dhe do te jene me te larta.

AKEP, vlereson mendimin e shprehur nga nje palet me interesese se performanca e nje brezi te caktuar dhe sasia (MHz) e spektrit ne perdorim, jane dy faktoret kryesore percaktues te vleres se spektrit, pra te pageses. Por, nuk ndan te njejtin mendim per kete ndarjen e brezit 1-17 GHz ne dy pjese, me koeficente te ndryshem per pjesen (1-10) GHz dhe ate (10-17) GHz. Performanca e ketyre brezave lidhen me gjatesine e lidhjes radio, qe per pagesen nuk eshte marre ne konsiderate per asnje brez frekuencash, kurse gjeresia e kanalit radio, sidomos per 11 e 13 GHz eshte e njete me ate te brezit 6-10 GHz.me gjeresi per transmetimi STM.

Perfundimisht, AKEP mendon te vazhdojë me propozimet e përshkruara në Dokumenti e keshillimit publik, dhe do te shqyrtojë situatën gjate 3 viteve të zbatimit te ketyre pagesa për të vlerësuar efektivitetin e saj zbatimit për të vlerësuar efektivitetin e saj ne te gjithë brezat e frekuencave.

Pyetja 10.

AKEP i konsideron te drejta verejtjet e palet me intereseseve per mos publikimin e planit te perdorimit te frekuencave, vonesave ne miratimin te kerkesave per pajisjen me autorizim individual per perdorimin e frekuencave, mungeses se percaktimeve te qarta per ndryshimet e lidhjeve fikse te radio ekzistuese dhe te dispozitave qe percaktojne afatet dhe kohen kur duhet te kryen pagesat per Autorizimin Individual.

Aktualisht ka filluar publikimi ne faqen elektronike te Planit te Perdorimit te Frekuencave. Plani i Veprimit te AKEP per viti 2010, parashikon pergatitjen e procedura te reja per pajisje me autorizim individual me qellimin zvogelimin e kohes ne plotesimin e kerkesave te paleve me interes.

Procedura e reja ne te njejten kohe do t'ju japin pergjigje dhe verejtjeve te interesuarit qe ka shprehur rezerva per kuadrin rregullator te deritanishem, per te cilen e ka dhene konsiderta, jashte etikes zyrtare dhe te pa bazuara.

AKEP, lidhur me ndryshimet ne lidhjet fikse jep keto percaktime:

Modifikim i lidhjes radio – eshte rasti kur stacionet e lidhjes fikse Pike-Pike, Pike - Shume Pika, lidhjet fikse satelitore nuk ndryshojne pozicionet e tyre gjeografik (koordinatat gjeeografike) te instalimit, por ndryshojne parametrat e lidhjes/ve: brezi i frekuences/ave te punes, gjeresia e brezit te kanalit te frekuences, pajisjet transmetuese dhe antenna, te cilet cojne ne kryerjen e analizave inxhinierike te pajtuesmerise (EMC- Electro Magnetic Compatibility) te kesaj lidhjeje radio me shebimet e tjere radio. Ne kete rast Autorizimi individual mban po numrin e meprashem, por ndryshohen te dhenat e lidhjes fikse radio.

Ndryshim i lidhjes radio – është rasti kur te pakten njeri nga stacionet fiks radio ndryshon pozicionin e tij gjeografik, pavaresisht ne se ndryshojne ose jo parametrat e tjere teknike te lidhjes radio. Ne kete rast Autorizimi Individual i lidhjes se me parshme revokohet dhe sipermarresi pajiset me nje autorizim te dyte te ri.

Pagesat per lidhjet radio te ndryshuar dhe/ose te modifikuar jane sqaruar ne n/piken 8 te paragrafit 4.5. Lidhjet fikse radio te dokumentin e keshillimit publik.

Pyetja 11 dhe 13.

Palet me interes shprehen dakort me propozimin e dhene ne dokumentin e keshillimit publik per pagesat per lidhjet fikse radio qe perdorin te dy polarizimet V e H , me nje kanal frekuence radio dhe ato njedrejtimshe.

Pyetja 12.

AKEP sqaron se pagesa e propozuar ne pikes 4 te paragrafit 4.5 Lidhjet fikse radio te Dokumentit te keshillimit publik, i referohet lidhjeve fikse PMP ne brezin e frekuencave poshte 1 GHz, qe perdoren per sistemet PMR, gjeresia e kanalit te frekuencave te te cileve eshte eshte shume me vogel se ajo qe aplikohet ne lidhjet fikse radio PP, prandaj nematerialin perfundimtar AKEP, per keto lidhje do te percaktoj dhe gjeresine e kanalit radio ne kHz, mbi te cilen do te llogaritet pagesa.

Brezat e frekuencave mbi 1 GHz, qe perdoren per lidhjet PMP, jane te percaktuara ne PKRF sipas standardeve nderkombetare dhe dhenia e tyre ne perdorim jepen me procedura te vecanta , qe percaktohen ne ligjin “Per komunikimet elektronike dhe postare”.

Per arsyet e mesiperme, AKEP duhet te kete refuzuar kerkesen qe pretendon i intresuari per lidhje fikse radio PMP.

Pyetja 14:

AKEP, lidhur me propozimin e te interesuar qe pagesa per lidhjet fikse radio, te jene fikse per nje numer te caktuar lidhje radio ne rrjetin e transmetimit, nuk ndan te njejtin mendim.

Si dhe eshte theksuar ne dokumentin e keshillimit publik, qellimi i pagesave per perdorimin e frekuencave nuk ka qellim te vetem sigurimin e fondeve per adminstraten e institucionit, por dhe perdorimin efektiv te spektrit radio. Propozimi i te intresuarit do te

thote qe te mbetemi tek struktura e tanishme me pagesa fikse per lidhjet radio, por te diferencuar vetem nga sasia e ketyre lidhje, gje qe nuk e konsiderojme te drejte.

4.4 Sherbimi radio FWA/BWA

4.4.1 Përmbledhje e Keshillimit Publik.

Ne dokumentin e keshillit publik jane dhene konsiderata per sherbimin FWA/BWA si dhe propozimet:

- a) Per llojin e autorizimeve, per perdorimin e brezave te frekuencave FWA/BWA : lokal/rajonal dhe kombetar ;
- b) Per pagesen vjetore per perdorimin e frekuencave te caktuara per kete sherbim radio., qe merr parsysh tipin e autorizimit dhe gjeresine brezit ne rastin e autorizimit lokal/rajonal dhe gjeresia brezit dhe brezin e frekuencave ne rastin e autorizimit kombetar.
- c) Pagesa e brezit te frekuencave te sherbimit radio FWA/BWA per periudhe kohe me te vogel se nje vit do te llogaritet proporcional me kohen, por pagesa minimale do jete ajo per perdorim 1 muaj.
- d) Dhe se llogaritja e gjereses se brezit do te behet duke marr ne konsiderate te dy pjeset e brezit ne rastin FDD, dmth per brez 2x5 MHz, ne dispozicion te palet me intereset, llogaritja e pageses do te behet me brez me gjeresi 10 MHz.

Pyetje:

Pyetja 15 : Cili eshte mendimi juaj per propozimet e mesiperme per ndarjen ne zonat lokal/rajonal ?

Pyetja 16 : Cili eshte mendimi juaj per propozimet e mesiperme per pagesat per perdorimin e frekuencave per autorizimet perkatese ?

4.4.2 Mendime te paleve me interes.

Pyetja 15 : eshte dhene 1 pergjigje.

Nje i interesuar shprehet se e konsideron me te drejte opsionin e dhenies se autorizimeve vetem ne baze kombetare, duke argumentuar se autorizimet lokal/rajonal do te shkaktonin fragmentimin e tregut dhe meqe tregu eshte i vogel perfitimet e investimeve mund te mos jene te sigurta.

Pyetja 16 : Jane dhene 2 pergjigje.

I interesuari i pare propozon qe ne llogaritjen e pageses vjetore per autorizimet lokal/rajonal per perdorimin e brezit te frekuencave FWA/BWA te merret parsysh jo vetem gjeresia e brezit por dhe brezi i frekuencave.

Gjithashtu, i interesuari tjetër kërkon sqarimin për mos përputhje midis brezave të frekuencave për FWA/BWA dhënë në këtë dokument keshillimi me atë të përdorimit të BWA, - lidhur me brezin 2.0-2.3 GHz, dhe - pse nuk është përfshirë në dokumentin për pagesat për brezin (27.5-29.5) GHz.

4.4.3 Qendrimi i AKEP

Pyetja 15.

AKEP vlerëson mendimin e paleve me interes për dhënëien e të drejtës së përdorimit të brezve BWA në baze kombëtare, por nënvizon se vendimi përfundimtar do të merret dhe në baze të ofertave që do të paraqesin palet e interesuara, në dokumentin, që do të hartohet për marrjes së të drejtës së përdorimit të frekuencave FWA/BWA, sipas procedurave që përcakton ligji për komunikimet elektronike.

Pyetja 16

AKEP vlerëson vërejtje e të interesuarit dhe pranon pasaktësinë në përfshirjen e brezit 2 -3 GHz si dhe mos përfshirjen në dokumentin e keshillit publik brezin (27.5-29.5) GHz..

Pagesat për këtë brez do të kenë të njëjtin nivelin si dhe për brezin (24.5 – 26.5)GHz

4.5.AUTORIZIMET INDIVIDUALE PËR QËLLIME KËRKIMI, MATJEJE DHE PROVE

4.5.1 Përmbledhje e Keshillimit Publik.

Dokumenti i keshillimit publik evidenton qëllim e AKEP inkurajimin e inovacionin dhe zhvillimin e teknologjive të reja, për qëllime kërkimi, matjeje dhe prove të pajisjeve të radiokomunikimit, dhe përmban propozimet:

- a. Dhenien e Autorizimi individual për qëllime kërkimi, matjeje dhe prove të pajisjeve të radiokomunikimit të jete me afat vlefshmerie deri 90 dite, pa mundësi rinovimi (zgjatje) të këtij afati për qëllimet e mesipërme;
- b. Pagesa për AKEP të jete e menjëherëshme për gjithë periudhën e caktuar për testim.
- c. Llogaritja e pageses do të bëhet bazuar në pagesën vjetore të shërbimit përkatës radio. Ajo do të jete proporcionale me kohën e vlefshmerisë së AI, por nuk do të jete më e vogël se 15.000 leke/për muaj për çdo kanal të caktuar.

- d. PAGESA PER CAKTIM E FREKUENCES/AVE, PER CDO APLIKIM PER AUTORIZIMIT INDIVIDUAL PER PERDORIMIN E FREKUENCES, PER QËLLIME KËRKIMI, MATJEJE DHE PROVE TË PAJISJEVE TË RADIOKOMUNIKIMIT ESHTË 1.000 LEKE.

Pyetje:

Pyetja 24. Cilit është mendimi juaj për propozimet e mësipërme, lidhur me afatin e vlefshmërisë së Autorizimit Individual dhe pagesën për përdorimin e frekuencave për këtë shërbim radio.

4.5.2 Mendimi i paleve me interes.

Pyetja 24: Janë dhënë 3 përgjigje.

Një i interesuar propozon që autorizimi individual për këtë shërbim radio të jetë i rinovueshëm.

I interesuari tjetër parimisht është që pagesa të jetë simbolike dhe keshillon se AKEP para se të propozojë pagesa për këtë shërbim radio të caktojë rregulla për veprimtari të tilla.

I interesuar i fundit shprehët se janë dakord me afatin e propozuar dhe me pagesën përkatëse.

4.5.3 Qendrimi i AKEP

AKEP , vlerëson mendimet e paleve me interes, por do të aplikojë propozimet që janë dhënë në dokumentin e keshillimit publik.

4.6. PAGESAT PËR CAKTIMIN DHE PËRDORIMIN E NUMRAVE DHE SERIVE NUMERIKE

Pyetja 28: Cili është mendimi juaj për nivelin e pagesave për caktimin dhe përdorimin e numrave dhe serive numerike të dhëna në tabelën e mësipërme?

Pergjigjet per Pyetjen 28:

Opratori A.

a1) Sipas PKN te gjitha serite nen NDC-ne 6N, jane te rezervuara per Sipermarresin A dhe nuk mund te perdoren nga Sipermarres te tjere. Keshtu qe eshte me e arsyeshme te behet tarifimi per cdo numer dhe jo per cdo bllok prej 10.000.

Qendrimi i AKEP:

Ne "Rregulloren per Caktimin dhe Perdorimin e Numrave dhe Serive Numerike dhe Planit Kombetar te Numeracionit"(VKD 932, 11.08.2009-Neni 9/3), per caktimin e Numrave te Levizshem(Neni 9/3) jane percaktuar serite 1 000 dhe serite 10 000 numrash. Keto seri jane standardi me i perdorshem edhe nga vendet e tjera europiane, duke mos permendur qe shume prej tyre perdorin edhe standardin e serive prej 100.000 numrash(AEC-Maqedonia). Edhe ne praktiken e operatoreve mobile ne vendin tone kerkesat per seri numerike (MSISDN) jane te pakten te rendit 10 blloqe nga 10.000 numra(100.000 numra).

Per sa i perket tarifimit per serite me te medha pagesa vjetore per numer eshte me i vogel dhe anasjelltas (ne rastin tone ky raport eshte ruajtur 1 me 4).

a2) Per pagesen e Kodeve SMS-VAS do te kerkonim ne menyre te vecante marrjen ne konsiderate te faktorit kohe ne llogaritjen e pagesave (kohezgjatjen e perdorimit te nje kodi te shkurter per sherbimet SMS/MMS me vlere te shtuar gjate nje viti). Konsiderata jone eshte qe nuk duhet te paguajme nje takse te plote vjetore per numrat e shkurter te cilet perdoren p.sh. per dy jave apo ndonjehere edhe per dy dite.

Qendrimi i AKEP:

"Rregullorja per Caktimin dhe Perdorimin e Numrave dhe Serive Numerike dhe Planit Kombetar te Numeracionit"(VKD 932, 11.08.2009- Neni 20/4), percakton qe "AKEP cakton drejtperdrejt Kode SMS-VAS individuale per ofruesit e sherbimeve SMS-VAS".

Per sa i perket tarifimit, ne Ligjin Nr.9918, date 19.05.2008 "Per Komunikimet Elektronike ne R.SH."(Neni86/3), pecaktohet qe "pagesa per perdorimin e numrave dhe

të serive të numrave të caktuara bëhet për çdo vit...”. Megjithatë për rastin e përdorimit të perkohshëm, përdorimit eksperimental ose rezervimit të numrave mund të parashikohet një pagesë e pjesshme. Kjo pagesë sipas praktikave të përdorura (AEC, AgCom-Itali, CRA-B/Hercegovina) është 50% e vlefave normale të pagesave.

a3) Nuk ka arsye të paguhet kod portabiliteti. Ky është një kod opsional, pjesë e një zgjidhjeje Portabiliteti për të cilën është rënë dakort mes operatorëve dhe autoritetit rregullator (konsultimi i parë publik për Portabilitetin e Numrave). Metodatat e tjera të mundshme të rrugëzimit nuk e kërkojnë përdorimin e këtij kodi.

Qëndrimi i AKEP:

Ne “Rregulloren për Caktimin dhe Përdorimin e Numrave dhe Serive Numerike dhe Planit Kombëtar të Numeracionit” (VKD 932, 11.08.2009- Neni 25/3), përcaktohet që “AKEP cakton drejtpërdrejt kode individuale të rrugëzimit për portabilitetin e numrit për ofruesit e shërbimeve të disponueshme për publikun”. Sipas praktikave të përdorura në vende të tjera konstatohet që disa e kanë të afishuar si të vetë pagesën për kodin e ofruesit të portabilitetit (NPT-Norvegji,) dhe të tjere e kanë të grupuar në zerin e pagesave për kodet e shkurtër 4 shifrore (CRA-B/Hercegovina).

a4) Rregullatori nuk u ka caktuar kurrë operatorëve seri të ISPC dhe NSPC (kodet e pikave të sinjalizimit kombëtarë dhe ndërkombëtarë). Prandaj, për momentin nuk ka arsye për të paguar për to. Kjo do të kishte kuptim vetëm në rast se rregullatori do t'i planifikonte dhe caktonte me kujde këto kode.

Qëndrimi i AKEP:

Për sa i përket Caktimit të Kodeve të Pikave të Sinjalizimit (SPC), sikurse në vendet e tjera evropiane, edhe pas liberalizimit të tregut të telekomunikacioneve dhe krijimit të institucioneve rregullatore të telekomunikacioneve, është trajtuar nga operatorët “incumbent”, të cilët ishin operatorët e vetëm në treg dhe caktonin Kodet e Pikave Nderkombëtarë të Sinjalizimit-ISPC, në përputhje me Rek.ITU-T Q.708, dhe Kodet e Pikave Kombëtarë të Sinjalizimit-NSPC, në përputhje me Rek.ITU-T Q.704, për nevojat e

rrjeteve te tyre. Ne rastin tone operatori “incumbent” eshte ALBtelecom Sh.a. i cili trashegoi edhe trajtimin e Kodeve te Pikave te Sinjalizimit (SPC).

Me futjen ne treg te operatoreve alternative, operatoret “incumbent” vazhduan te caktonin Kodet e Pikave te Sinjalizimit (SPC), edhe per operatoret e rinj qe futeshin ne tregun e telekomunikacioneve. Por me shtimin e shpejte te operatoreve ne treg, filloi gradualisht transferimi i pergjegjesise per caktimin e Kodeve te Pikave te Sinjalizimit(SPC) nga operatoret “incumbent” ne Autoritetet Rregullatore Kombetare (NRA). Ne rastin tone operatori “incumbent” ishte ALBtelecom Sh.a. i cili trashegoi edhe trajtimin e Kodeve te Pikave Kombetare te Sinjalizimit (SPC).

Per momentin Plani i Kodet e Pikave Nderkombetare te Sinjalizimit-ISPC trajtohet nga AKEP(pervec AMC te gjithë operatoreve e tjere mobile Kodin ISPC ja u ka caktuar AKEP), ndersa Plani i Kodet e Pikave Kombetare te Sinjalizimit-NSPC trajtohet akoma nga ALBtelecom Sh.a. Nderkohe AKEP eshte duke u pergatitur per transferimin e pergjegjesise per caktimin e Kodet te Pikave Kombetare te Sinjalizimit (NSPC) nga Sipermarresi ALBtelecom Sh.a. ne AKEP (planifikuar per tu kryer brenda vitit 2010). Per sa i perket pagesave, te gjithë rregullatoret e konsultuar aplikojne pagese per perdorim vjetor jo vetem per Kodet SPC por edhe per Kodet MNC(MCC+MNC).

a5) Koment i pergjithshem mbi keto ceshtje:

-Tarifa per perdorimin vjetor eshte shume me e larte se tarifa fillestare.

Ne vendosjen e tarifave per perdorimin e numrave dhe serive numerike nuk jane shpjeguar kriteret, referenca apo formula si jane llogaritur tarifat vjetore dhe fillestare ne zbatim te nenit 86 te ligjit te komunikimeve elektronike. Pyetja jone eshte se mbi c’baze jane llogaritur keto tarifa?

-Si parim i pergjithshem, pagesat e operatoreve behen per te mbuluar kostot e rregullatorit, per punen e bere per planifikimin, caktimin dhe perdorimin sic duhet te burimeve(numeracionit ne kete rast). Ky eshte nje argument ne mbeshtetje te komenteve per Nr.10, 11, 12 me lart.

Qendrimi i AKEP:

Pergjigjen per komentet e mesiperme e keni te permbledhur ne faqen 28, paragrafi i gjashte ne dokumentin e publikuar per keshillim publik "Mbi pagesat qe kryhen ne AKEP"(VKD Nr.1128, date 26.01.2010), ku thuhet:"Nga dokumentat rregullatore, te konsultuara deri tani, per llogaritjen e pageses vjetore per perdorimin e numrave dhe serive numerike te caktuara, verehet se pagesa vjetore per perdorimin e numeracionit, ndonse ruajne raporte pak a shume te peraferta per sa i perket llojeve te numrave dhe serive numerike, ne vlera absolute kane diferenca te konsiderushme ne rritje. Vlerat e pagesave per perdorimin e numeracionit per zerat e vecante ne pergjithsi jane parashikuar te ulura dhe ruajne nje nivel te perafert me nivelin e pagesave aktuale."

Megjithate niveli i pagesave qe kryhen ne AKEP per perdorimin vjetor te frekuencave(Neni 78 i ligjit Nr.9918), perdorimit vjetor te numeracionit(Neni 86 i ligjit Nr.9918) dhe mbikqyrjes se tregut te komunikimeve elektronike(Neni 24 i ligjit Nr.9918) percaktohet nga niveli i kostove administrative te AKEP. Kjo vlere ndahet ne menyre proporcionale duke planifikuar edhe kuoten per pagesat qe duhet te kryhen ne AKEP per Numeracionin. Pra keto kuota nuk jane absolute dhe nuk mbesin te pandryshuara. Per me teper ato duhet te rivleresohen ne cdo dy vjet ne vartesi te nivelit te inflacionit, etj. Persa i perket nivelit te pagesa vjetore per tipe te vecanta te numeracionit ato jane konsultuar me dokumentacionin e rregullatoreve europiane. Por edhe ketu nuk ruhet nje raport i caktuar ne pagesat vjetore per tipet e ndryshme te numeracionit dhe aq me pak nje raport i caktuar per vlerat e tyre absolute. Kjo ilstrohet ne Tabelen 5-2 (Krahasuese e Rregullatoreve) bashkengjitur.

a6) Konsiderata te tjera te pergjithshme:

-Dokumenti per pagesat eshte publikuar ne 2 shkurt 2010 dhe afati i publikimit eshte 30 dite. Ne kete dokument paraqiten pagesa shtese per operatoret te cilat nuk kane qene me pare. Meqenese keto pagesa nuk jane bere me pare ato nuk kane qene parashikuar ne buxhetin e kompanise per 2010. Keshtu keto pagesa shtese duhet te implementohen per

vitin 2011, ne menyre qe kompania te kete mundesine te parashikoje dhe alokoje ne buxhetin e vitit te ardhshem.

Qendrimi i AKEP:

Sikurse u shpjegua edhe me siper ketu nuk behet fjale qe pagesat shtese per numeracionin per zera te rinj do te rrisin buxhetin e AKEP duke renduar mbi buxhetin e kompanive per 2010. Buxheti i AKEP mbetet i njejte, ne kete rast behet vetem rishperndarje e pagesave qe kompania kryhen ne AKEP.

Pra neqoftese do te hiqej pagesa per numeracionin, kjo vlere e munguar do te kalonte ne rritjen e pagesave per perdorimin e frekuencave, mbasi vlera totale mbetet e pandryshuar.

Aplikimi i pagesave per perdorimin e frekuencave dhe numeracionit kryesisht kushtezohet nga fakti qe ato jane burime te fundme dhe duhet te mire administrohen dhe te perdoren me eficence.

Operatori B

b1) Vodafone Albania shprehet e mendimit se ne kuader te rishikimit te Pagesave per AKEP, pagesat e tjera per numrat dhe serite numerike duhet te hiqen.

b2) Neni 12 i Direktives se Autorizimit¹ shprehet se, pagesat duhet te mbeshteten ne kostot administrative te organit rregullator(ne kete rast AKEP). Duke konsideruar qe administrimi i numrave eshte nje pjese e vogel e veprimtarise se AKEP keto kosto mbulohe nga pagesa per mbikqyrjen e tregut(Neni 24 i Ligjit Nr.9918). Vodafone sugjeron qe eshte e pajustificueshme dhe e panevojshme te paguhen tarifa extra per numrat nderkohe qe buxheti i AKEP-it mund te financohet plotesisht nga tarifatat sipas

¹ Neni 12-Pagesat Administrative

1. Te gjitha pagesat administrative qe duhet te paguajne sipermarresit qe ofrojne nje sherbim ose rrjet sipas Autorizimit te Pergjithshem ose te cileve ju eshte dhene nje e drejte per perdorim duhet qe:

(a) ne total te mbulojne vetem shpenzimet administrative per administrimin, kontrollin dhe zbatimin e skemes te autorizimit te pergjithshem dhe te te drejtave per perdorim dhe detyrimeve te vecanta sikurse permenden ne Nenin 6(2), qe perfshijne kostot per bashkepunim nderkombetar, harmonizimin dhe standartizimin, analizen e tregut, monitorimin dhe kontrolle te tjera, po ashtu punet rregullatore per pergatitjen dhe zbatimin e vendimeve administrative dhe te legjislacionit sekondar, sikurse vendimet per aksesin dhe interkoneksionin; dhe

(b) te percaktohen ne menyre objektive, transparente dhe proporcionale per sipermarresit individuale, qe te minimizohen kostot administrative shtese.

2. Autoriteti Rregullator Kombetar percakton kostot administrative, dhe cdo vit duhet te beje publik planin vjetor te shpenzimeve administrative dhe shumen totale te pagesave te mbledhura. Mbas verifikimit te diferences ndermjet shumes se pagesave dhe kostove administrative, behen rregullimet perkatese.

nenit 24 te Ligjit Nr.9918 date 19.05.2008 “Per Komunikimet Elektronike ne Republiken e Shqiperise”, dhe tarifat e monitorimit te frekuencave(neni 78). Kete qendrim mbajne edhe ekspertet e BERZH dhe BE ne projekt Amendamentin e Ligjit Nr.9918 qe eshte pergatitur.

Qendrimi i AKEP:

Ligji nr.9918, date 19.05.2009 pervec pageses per caktimin e numeracionit(percaktuar sipas ligjit nr.8618, date 14.6.200) ka futur edhe pagesen per perdorimin vjetor te numeracionit (neni 119/ç). Ky ndryshim eshte bere duke marre parasysh edhe praktiken e vendeve europiane, te cilat ne pjesen me te madhe te tyre i aplikojne te dyja pagesat(si Belgjika, Cekia, Greqia, Hungaria, Sllovakia, Hollanda, Lituania, Bosnje/Hercegovina, etj), nje pjese aplikojne vetem pagesen per perdorimin vjetor te numeracionit(si Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Itali, Polonia, Sloveni, etj) dhe disa vetem pagese per caktimin e numeracionit (si Gjermania). Kjo ilustruhet ne Tabelen 5-3 (Pagesat per Vendet e EU) bashkengjitur.

Eshte per tu theksuar se:

- *Cmimet e perdorura nga keto shtete jane shume me te larta se cmimet e perdorura ne R.SH.(sipas VKM nr.75, date 06.02.2003);*
- *Pervec numeracionit qe trajtohet ne Planin Kombetar te Numeracionit (Rek. ITU-T E.164) AKEP cakton edhe numra dhe kode jashte ketij si Kodin e Pikes Nderkombetare te Sinjalizimit-ISPC(Rek.ITU-T Q.708), Kodin Mobile te Vendit dhe Kodet e Rrjeteve Mobile-MCC/MNC (Rek.ITU-T E.212), Kodin e Identifikimit te Rrjetit Transmetim te Dhenash-DNIC(Rek.ITU-T X.121), etj.- qe nuk perfshihen ne VKM nr.75, date 06.02.2003;*
- *Deri tani Sipermarresit kane paguar vetem nje here, pagesen per caktimin e numeracionit.*

Arsyeja pse Sipermarresit duhet te paguajne per perdorimin e numeracionit nuk lidhet vetem me faktin se ata shfrytezojne nje pasuri kombetare te fundme², por lidhet edhe me

² **Neni 19-Dhënia e së drejtës për përdorim**

1. Sipërmarrësit që kanë nevojë për caktim të burimeve natyrore të fundme (frekuenca dhe numeracion), në njoftimin që paraqesin në AKEP, sipas nenit 14 të këtij ligji, kërkojnë dhënien e së drejtës së përdorimit të tyre.

krijimin e kushteve per mire administrimin e numeracionit nga Rregullatori(AKEP). Ne ligjin nr. 9918 Neni 80- Plani i Numeracionit percaktohet:

2. AKEP-i administron planin e numeracionit në mënyre që:

- a) të sigurojë strukturimin dhe përdorimin eficient të numrave dhe serive numerike;*
- b) të kënaqë nevojat e arsyeshme të operatorëve dhe ofruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike për caktim të numrave, sipas këtij ligji;*

Nga eksperiencia e deri tanishme, Sipërmarresit megjithese nuk paguajne per perdorimin vjetor te numeracionit, por vetem nje here kur ju caktohet numeracioni, jane te kufizuar ne kerkesat e tyre vetem nga pagesa(per frekuencat kufizimi eshte edhe me i ndjeshem mbasi per to ka nje pagese vjetore per perdorimin e tyre).

Pra eshte me e arsyeshme qe te reduktohet pagesa sipas nenit 24(pagesat per mbikqyrjen e tregut) per aq sa Sipërmarresit duhet te paguajne per perdorimin vjetor te numeracionit. Ne kete rast Sipërmarresi eshte me i vetedijshem per se paguan dhe kerkesa nga ana e tij do te jete ne perputhje me nevojat qe ka per perdorimin e numeracionit.

Ne rast te kundert Sipërmaresi duke e quajtur veten te likujduar me pagesat ne AKEP(sipas nenit 24) do te beje kerkesa te pa kontrolluara, do te marre dhe do te ktheje numeracionin pa asnje kufizim, duke zeruar ne kete menyre kriteret per numeracionin mbi te cilat eshte ndertuar Plani Kombetar i Numeracionit. Te mendojme per nje cast sikur te hiqet pagesa per perdorimin e frekuencave dhe vlera qe duhet paguar per to te realizohet duke modifikuar nenin 24. Llogjika eshte e njejte edhe per numeracionin, pavaresisht se pesha qe ze ne pagesat vjetore eshte shume me e vogel se sa ajo per perdorimin vjetor te frekuencave.

Se fundi nuk kemi pse te anashkalojme eksperiencen e vendeve europiane, te cilat synojme t'i arrijme.

b3) Veme re se pagesat per numeracionin sipas propozimit te dokumentit per keshillimin publik jane rritur jashtezakonisht shume pa shpjeguar aresyet e rritjes se tyre. Gjithashtu e kemi te veshtire te kuptojme vendosjen e Pagesave Vjetore per Perdorimin e Numrave dhe Serive Numerike pasi nuk eshte dhene shpjegim se per cfare aresye behen keto pagesa. Nga ana tjetere, nuk ka asnje kuptim qe pagesat per numeracionin te konceptohen si shitja e nje te drejte perdorimi te numrave, si nje burim i kufizuar. Pagesa fillestare per autorizimin e hyrjes ne treg mund te quhet me se e mjaftushme per nje pagese te tille. Vodafone Albania i ngelet parimit baze qe te gjitha pagesat e AKEP duhet te mbesheten ne buxhetin vjetor te tij dhe parimin e mbulimit te kostove administrative per shpenzimet lidhur me sherbimet ne fjale.

Me konkretisht, AKEP ka parashikuar krijimin e nje pagese fikse per caktimin e numrit(qe kryhet vetem nje here) dhe nje pagese vjetore qe nuk ka egzistuar me pare. Vlerat e pagesave vjetore jane ne shumefishin e pageses per caktimit e numrit(kjo e fundit logjikisht duhet te mbuloje shpenzimet administrative) dhe sic e theksuam me siper nuk justifikohet ne dokument aresyeja e vendosjes se tyre.

Qendrimi i AKEP:

Pagesat per tipet e numeracionit qe percaktohen sipas VKM 75, date 6.2.2003, jane ruajtur ne vlerat ekzistuese, por tani kjo pagese do te jete pagesa per perdorimin vjetor te numeracionit. Pagesa per caktimin e numeracionit eshte nje pagese minimale e standartizuar qe paguhet vetem nje here. Per sa i perket tipeve te numeracionit qe nuk perfshihen ne VKM 75, date 6.2.2003, ato (me disa sakesime te vogla), jane ne nivelet me te ulta ne krahasim me vendet e tjera europiane. Kjo ilustruhet ne Tabelen 5-2 dhe Tabelen 5-3 (bashkengjitur).

Per sa i perket vendosjes se pageses per perdorimin vjetor te numeracionit, kjo eshte e percaktuar ne Nenin 86 te Ligjit Nr.9918.

Fakti qe numeracioni dhe frekuencat trajtohen si burime te kufizuara, konfirmohet edhe ne Nenin 19-Dhënia e së drejtës për përdorim- te Ligjit Nr.9918.

b4) AKEP ka parashikuar shtimin e ndjeshem te kategorive te vecanta te numrave per te cilet operoret duhet te paguajne tarifa. Praktikisht cdo kategori e numeracionit e permendur ne Rregulloren per Numeracionin eshte pasqyruar ne Tabelen e Pagesave per Numeracionin e propozuar nga AKEP. Aty jane perfshire edhe pagesa per numeracion qe jepet nga ITU si Kodet e Pikave Nderkombetare te Sinjalizimit, qe normalisht nuk jane ne administrimin e AKEP dhe nuk justifikohet aresyeja pse operoret duhet te kryejne pagesa per keto numra.

Qendrimi i AKEP:

Shtimi i kategorive te numeracionit ne listen e pagesave per perdorim vjetor te numeracionit eshte bere ne perputhje me praktikat e rregullatoreve te tjere europiane. Kjo mund te konstatohet edhe ne Tabelen 5-2(bashkengjitur). Per sa i perket numeracionit qe caktohet nga ITU per R.SH., sqarojme se:

-ITU cakton Kodin SANC(seri tete-ISPC) per R.SH.,ndersa Kodet ISPC jane kopetence e AKEP;

- ITU cakton Kodin MCC per R.SH.,ndersa Kodet MNC jane kopetence e AKEP;

b5) Konsiderata te tjera:

Si perfundim, Vodafone Albania kundershkon kete propozim te AKEP, dhe mbeshtet propozimin e eksperteve te BERZH per te hequr fare pagesat rregullatore per numeracionin, si zgjidhja me logjike dhe ne perputhje te plote me praktiken rregullatore te BE-se, per shkak se te drejtat per perdorimin e numeracionit jane paguar ne momentin e marrjes se licenses/autorizimit per te operuar ne treg, ndersa kostot administrative te AKEP per administrimin e ceshtjeve te numeracionit mund te perfshihen dhe mbuloohen nga pagesa per mbikqyrjen e tregut qe operoret do te kryejne ne AKEP.

Qendrimi i AKEP:

Pergjigja eshte dhene ne Qendrimi i AKEP per verejtjet b1) dhe b2).

Operatori C

c1) Eagle Mobile gjykon se niveli i pagesave per caktimin dhe perdorimin e numrave dhe serive numerike duhet te jete ne funksjon te perdoruesit. Ne vleresojme qe pagesa duhet te jete e ndryshme per operatoret e sherbimeve telefonike celulare ne krahasim me operatoret e tjere. Kjo pasi operatoret celulare perdorin nje brez te gjere numrash ne krahasim me subjektet e tjera.

Qendrimi i AKEP:

Ka praktika te rregullatoreve te vecante europiane(TOSR-Slovakia) qe aplikojne cmime te ndryshme per serite numerike per numrat gjeografike nga serite e numerike per numrat jo-gjeografike. Kjo mund te konstatohet ne Tabelen 2(bashkengjitur) ku pagesa per serite numerike per numrat jo-gjeografike eshte me e larte se pagesa per serite numerike per numrat gjeografike.

Megjithate, AKEP propozon eksperiencen e shumices se rregullatoreve qe ruajne nivel te njete pagesash per serite numerike, por te korregjuar me zbritje per numrat gjeografike Praktika e ndjekur deri tani i trajtonte serite numerike ne menyre te njejte.

Operatori D

d1) Lidhur me pagesat per numeracionin, shprehemi parimisht dakort per mekanizmin e perdorur ne baze te ligjit per kryerjen e dy pagesave per numrat dhe serite numerike, nje pagese per caktimin dhe nj pagese per perdorimin e tyre. Por shprehim serisht shqetesimin tone per mungesen e nje analize per llogaritjen e tarifave vjetore te vendosura per perdorimin e tyre. Per me teper, duke vleresuar te pakten periudhen e 10 viteve te fundit, prespektiven e se ardhmes, numrin e popullsisë dhe territorin, nuk rezulton qe numeracioni ne kushtet dhe rrethanat e Shqiperise te jete burim ne ezaurim e siper qe te justifikohet nje percaktim i pagesave ne nivel kaq te larte ne kuader te eficenses se perdorimit te numeracionit, pavaresisht se nga pikpamja matematikore ky eshte nje burim i fundem.

Qendrimi i AKEP:

Niveli i pagesave te propozuara per numeracionin jo vetem qe eshte me i ulti ne krahasim me rregullatoret e tjere, por ne shume raste ndryshon me disa here. Kjo mund te verehet nga kqyrja e Tabeles 5-2 dhe Tabeles 5-3(bashkengjitur).

d2) Duke qene se Albtelecom eshte e pajisur me nje sasi te konsiderueshme numrash dhe seri numerike, behet menjehere evidente pesha financiare me te cilen ngarkohet ky operator, peshe e cila pervec te tjerave rendon koston e sherbimeve tona. Ne kete kuader, do te kerkonim rikonsiderimin e pagesave per perdorimin e numrave dhe serive numerike per t'i ulur vlerat e tyre.

Qendrimi i AKEP:

Duke marre ne konsiderate verejtjet, AKEP propozon disa korregjime te mundeshme, te cilat jane reflektuar ne Tabelen 5-4(bashkengjitur).

d3) Nderkohe do te veconim si te papranueshme pagesat per caktimin dhe perdorimin e Kodeve per Kodet e Pikave Kombetare dhe Nderkombetare te Sinjalizimit. Kjo pagese nuk mund te perfshihet ne kuadrin e pagesave per numrat dhe serite numerike pasi keto kode nuk jane pjese e Planit Kombetar te Numeracionit i cili eshte miratuar se fundmi me VKD Nr.932, date 11.08.2009 te AKEP, ne zbatim te parashikimeve ligjore per Numeracionin. Nderkohe qe edhe vete ligji "Per Komunikimet Elektronike ne R.SH" ne nenin 119, pika 1 e tij nuk parashikon pagesa per Kodet e Pikave Kombetare dhe Nderkombetare te Sinjalizimit.

Qendrimi i AKEP:

Ne Ligjin Nr.9918, date 19.05.2008 "Per Komunikimet Elektronike ne R.SH."(Neni3/32),

jepet ky percaktim per Planin e numeracionit:

"Plani i numeracionit" është struktura e numrave dhe e serive të numrave, si dhe caktimi i tyre për sigurimin e aksesit në rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve publike.

Ky koncept qe sanksionohet edhe ne Nenin 80/1dhe ne Nenin 86, eshte shume me i

gjere se Plani Kombetar(Publik) i Numeracionit E.164, per te cilin behet fjale ne VKD 932, 11.08.2009- “Rregullore per Caktimin dhe Perdorimin e Numrave dhe Serive Numerike dhe Plani Kombetar i Numeracionit”. Vec Planit te Numeracionit (E.164) ketu bejne pjese edhe plane te tjera numeracioni jo-E.164 si me poshte:

- Plani i Kodit te Pikes Nderkombetare te Sinjalizimit -ISPC-(ITU-T Q.708),*
- Plani i Kodit te Pikes Kombetare te Sinjalizimit -NSPC-(ITU-T Q.704),*
- Plani i Kodit te Rrjetit Mobile-MCC/MNC-(ITU-T E.212),*
- Plani i Nderk. i Numeracionit per Rrjetet Publike DATA-DNIC-(ITU-T X.121), etj.*

Nenin 119/1ç- eshte ne perputhje te plote me Nenin 80/1dhe Nenin 3/32:

1. Pagesat, që kryhen në AKEP, janë:

ç) pagesa për caktimin dhe përdorimin e numrave dhe të serive numerike, sipas përcaktimeve në nenin 86 të këtij ligji.

Perfundimisht:

Duke marre ne konsiderate:

- 1)Verejtjet e Sipermarresve per Kapitullin 5-PAGESAT PER CAKTIMIN DHE PERDORIMIN E NUMRAVE DHE SERIVE NUMERIKE, te Dokumentit “Mbi pagesat qe kryhen ne AKEP”, publikuar nga AKEP per Keshillim Publik-sipas VKD Nr. 1128, date 26.01.2010;
- 2)Futjen ne treg te Sipermarresve dhe perdoruesve te rinj per numeracionin, dhe se shpejti te Operatorit MOBILE 4 AL;
- 3)Ndryshimet ne tregun e komunikimeve elektronike dy vitet e fundit, nga koha kur filloi procesi per pergatitjen e dokumentit per pagesat;
- 4)Detyrimin per rishikimin e cmimeve cdo dy vjet; propozojme qe:

1) Te behen ndryshimet perkatese ne tabelen “PAGESAT PER CAKTIMIN DHE PERDORIMIN E NUMRAVE DHE SERIVE NUMERIKE”, si ne Tabelen 5-4 (bashkengjitur);

2) Te shtohet ne fund te Tabeles 5-4:

Shenim:Pagesa per rastet e rezervimit te numeracionit, ose kerkeses per numeracion per per aplikime eksperimentale ose te perkoheshme eshte 50% e vleres se parashikuar ne tabelen me siper.